



MEMORANDUM INFORMIMI			
Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.75 PEJ098/2 - Stacioni i Veterinës - Istog			
Njësia e Vendosur në Tender	Njësia nr.204-Stacioni i Veterinarisë në Gurakoc		
Linku i vendndodhjes së Aseteve ¹	Objekti 1657		
Zona Kadastrale / Komuna	ZK Gurakoc Istog		
Kategoria e potencialit të pronës për shfrytëzim	Objekt		
Çmimi minimal për €/ari/Objekte	162.00 €/m ²	Sipërfaqja e pronës në m ²	102.90 m ²
Depozita e Ofertës	2,000.00	Dita e Ofertimit	09/09/2026 Ora: 10:00 - 12:00
Procesi i Ofertimit dhe Rregullat e Tenderit	Kriteret dhe procesi për përgatitjen dhe parashtrimin e ofertës janë përcaktuar në Rregullat e Tenderit		
Përshkrimi i Aseteve (Ndërtesat dhe tokat)			
Kjo shitje ofron Objektin e Stacionit të Veterinës me sipërfaqe totale prej 102.9m² sipas matjeve në terren dhe gjendet në Gurakoc, Komuna Istog. Objekti nuk është në gjendje të mirë dhe shtrihet në objektin e tipit përdhësë, ku pjesa me sipërfaqe prej 102.9m² është pronë e NSH Stacioni i Veterinës, ndërsa hapësira tjetër është në pronësi private. Ofertuesit potencial njoftohen se sipërfaqja e objektit që i bartet Blerësit është dhënë sipas matjeve në terren 102.9m² (neto). Objekti është ndërtuar prej materiali të fortë në vitet 60-ta, nuk është në gjendje të mirë dhe ka qasje në rrugë publike, me numër të parcelës nr.1122-0 (Magjistrallja Pejë-Mitrovicë). Pjesa e objektit në sipërfaqe prej 102.9m² i takon Stacionit të Veterinës, pjesa e kufizuar me ngjyrë të verdhë siç është paraqitur në ortofotot, kurse pjesa tjetër e objektit është në pronësi private. Toka ku ndodhet Objekti i Stacionit të Veterinës - parcela kadastrale 136-3 ZK Gurakoc evidentohet në emër të P.SH Kuvendi Komunal Istog andaj toka NUK është pjesë e shitjes.			
Shfrytëzuesit	Për këtë objekt është nënshkruar kontratë qiraje e cila skadon me datë 31/05/2027.		
Asetet tjera	Objekti i Veterines		
Detyrimet që do të barten	Nuk ka detyrime të bartura.		
Dokumentet pronësore			
Blerësi i ardhshëm do të ketë mbi vete përgjegjësinë për regjistrimin e pronës, në Regjistrat përkatës Publik, dhe për rreziqet dhe pengesat që mund të paraqiten në procedurën e regjistrimit. AKP-ja nuk			

¹ Të dhënat e hartës ©2026 Geoportal

Akt-mohim: Vendndodhjet e reguara nga PIN-at në Geoportal ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.



merr mbi vete kurrfarë përgjegjësie lidhur me këto çështje. Ndërmarrja dhe AKP-ja nuk posedojnë dokumente të mjaftueshme pronësore për këtë lokal afarist i cili është pronë e Ndërmarrjes. Megjithatë : Në përputhje me nenin 5.3 të Ligjit të AKP-se nr. 04/L034: Autoriteti administrativ i Agjencisë i paraparë në nenin 5 paragrafi 1.1. do të vlejë për të gjitha pronat në pronësi apo posedim të ndërmarrjes, përfshirë pronat që gjenden jashtë Kosovës; Neni 27 i Shtojcës së Ligjit përcakton: Vendimi për likuidim krijon një pronë likuide të përbërë nga të gjitha asetet në pronësi ose posedim të ndërmarrjes në kohën kur është miratuar vendimi, përfshirë si në vijim por pa u kufizuar në to: 1.1. Të gjitha pronat e luajtshme, të paluajtshme kudo që ndodhen, qoftë në posedim apo në kujdestari të ndërmarrjes apo palës së tretë; Ndërmarrja është në posedim dhe shfrytëzim të objektit “Stacioni I Veterinës në Gurakoc”, qysh nga ndërtimi i objektit gjatë viteve të 60-ta. Posedimi vazhdimisht ka qenë: - me mirëbesim, pasi Ndërmarrja çdo herë e ka konsideruar veten pronare e të objektit, - i qetë, pasi askush nuk e ka penguar Ndërmarrjen në shfrytëzimin e objektit dhe veprimtarisë të tij, dhe nuk ia ka kontestuar të drejtën e pronësisë. - i pandërprerë pasi askush nuk e ka privuar ndërmarrjen nga posedimi. AKP-ja nuk ka të dhëna se është kontestuar ndonjëherë e drejta e pronësisë së ndërmarrjes, apo të ketë pasur ndonjëherë pretendime pronësore nga subjektet e tjera, mbi objektin. Në Dhomën e të dhënave të AKP-së, nuk ka të regjistruar asnjë ankesë apo padi pronësore, lidhur me këtë objekt.

Foto/fotot Ose informata të tjera Për asetet në shitje





Prona është e regjistruar në emër të paraardhësit të NSH-së. Sipas Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2005/12 për zbatimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës së Shfrytëzimit të Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, neni 3, në mes tjerash ceket se “dhënia me qira themelohet në pajtim me dispozitat e Rregullores për përdorimin e tokës edhe nëse e drejta e shfrytëzimit të pasurisë së përmendur është regjistruar në emër të paraardhësit ligjor të Ndërmarrjes Shoqërore apo në emër të cfarëdo subjekti...”.

Të gjitha asetet e përfshira këtu janë ofruar për shitje në bazë të “siç është” dhe “ku është” dhe do të shiten në pajtim me termat dhe kushtet ligjore të shitjes. Veçanërisht dhe pa ndryshuar këto terma, AKP-ja nuk jep asnjë garanci të shprehur apo të nënkuptuar për sa i përket kushteve të asetit (eve) të shitur-a, ose përshtatshmërisë së tyre për çfarëdo përdorimi ose qëllimi. Verifikimi i përshkrimit dhe kushteve i të gjitha aseteve është përgjegjësi e ofertuesit.

AKP-ja, me takim të paracaktuar, do të lejojë blerësit potencialë të inspektojnë të gjitha të dhënat dhe dokumentet që janë në dispozicion në lidhje me asetet, në Zyrën Qendrore të AKP-së në Prishtinë.

Informatat që janë dhënë në Memorandumin për Informim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike, për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk merr përgjegjësi, pa marr parasysh natyrën e tyre. Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk garanton ose nuk merr përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë e ndonjë ankese, deklarate ose informate në këtë Memorandum për Informim. Agjencia Kosovare e Privatizimit në asnjë rrethanë nuk është përgjegjëse për çfarëdo dëmi, qoftë i



drejtpërdrejtë, tërthorë, i veçantë, i rastësishëm, me pasoja, ose dëme të tjera përfshirë por jo vetëm, humbjen e fitimit, pavarësisht nëse Agjencia Kosovare e Privatizimit është këshilluar për mundësinë e dëmeve të tilla që rrjedhin nga pasaktësitë (ose mos përfshirja e informacionit) në këtë dokument ose nga përdorimi ose paaftësia për të përdorur këto informata. Këto Informata nuk ju kufizojnë për këshillimin profesional të pavarur ose inspektimet apo kërkimet e pavarura para marrjes së vendimit për blerjen e aseteve.

Inkurajohen ofertuesit potencial të kryejnë hulumtimin e tyre paraprak në këtë çështje dhe do të konsiderohen se janë në dijeni për të gjitha të dhënat publike që i përkasin hipotekës/pengut. Blerësi potencial është plotësisht përgjegjës që vetë të bëjë hulumtimin e tij paraprak të gjendjes. As AKP dhe Autoriteti i Likuidimit nuk marrin përgjegjësi për ndonjë ngarkesë ose peng në pronë.

“Shënim: Deri më tani në lidhje me kërkesat e kreditorëve, të pronësisë dhe atyre për rikthim vlejné dispozitat e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që konstatojnë të drejtën, titullin apo interesin për ndonjë pasuri në posedim apo kontroll të ndonjë ndërmarrje të privatizuar nga AKP-ja. Nëse Dhoma e Posaçme më vonë përcakton se pretenduesi ka qenë një pronar legjitim për ndonjë pasuri apo interes që ndërlidhet me ndonjë pjesë të pasurisë, atëherë në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të po këtij ligji, parashtruesi i kërkesës do të jetë i kualifikuar vetëm për kompensim monetar. AKP nuk garanton që juridiksioni i Dhomës se Posaçme do të ketë një interpretim tjetër në lidhje me nenin 10 dhe nuk do e njej interesin e kërkuarit për atë aset”.

AKP-ja interpreton nenin 10.3 duke e definuar që çdo kërkesë për kompensime monetare duhet të jetë kundër ndërmarrjes e cila ka shitur pjesë apo në tërësi pasurinë dhe jo kundër AKP-së apo blerësit të ri të kësaj pasurie. Duke marr parasysh rregulloret e pa testuara ligjore, nuk mund të sigurohet se Dhoma e Posaçme ose gjykatat tjera do të pajtohen me këtë interpretim, andaj blerësi i ri duhet të jetë i vëmendshëm me rreziqet e mundshme.

Ofertuesi potencial këshillohet të hulumtoj dhe të verifikoj numrin, madhësinë dhe shtrirjen e Rugëve po ashtu të pajtohet dhe të marr përsipër të mos i mbyllë dhe as të pengojë Rugët, por t'i lërë ato të hapura dhe të kalueshme për palët e treta, përveç nëse autoritetet përkatëse japin autorizim apo leje të duhur për t'i mbyllur rrugët.

Gjithashtu ofertuesit potencial inkurajohen të kryejnë hulumtim nëse ngastrat e ofruara për shitje janë të përfshira në planin urban të komunës. AKP nuk merr përgjegjësi nëse në të ardhmen blerësit i shfaqet ndonjë pengesë që lidhet me potencialin e shfrytëzimit të pronës.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) **nuk mban përgjegjësi** për mospërputhjet ndërmjet të dhënave **tekstuale** (në Certifikatën e Pronësisë) dhe të dhënave **grafike** (plane kadastrale, ortofoto, skica) apo **gjendjes faktike në terren** lidhur me pasurinë që ofrohet për shitje.

Shitja bëhet **në gjendjen ekzistuese** (“as-is”), dhe çmimi bazohet **vetëm në sipërfaqen dhe përshkrimin në Certifikatën e Pronësisë**.

Blerësi është përgjegjës për të kryer verifikimet e nevojshme teknike dhe ligjore **para blerjes**, dhe **nuk mund të kërkojë kompensim apo anulim të kontratës** për shkak të këtyre mospërputhjeve, as para e as pas shitjes. Duke dorëzuar ofertën e vet dhe/ose duke nënshkruar Kontratën e Shitjes, Blerësi **pranon pa rezerva** këtë Aktmohim, kushtet e tij dhe pasojat ligjore që rrjedhin prej tyre.

Për më tepër, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk bën asnjë deklaratë për ndonjë informatë tjetër që mund të qaset përmes përdorimit të këtij Memorandum Informimi. Informatat e përfshira në këtë Memorandum për Informim nuk mund të ndryshohen ose riprodhohen në mënyrë elektronike apo formë tjetër, pa lejen paraprake me shkrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka të drejtë të bëjë ndryshime dhe azhurnime në këtë Memorandum për Informim.

Pyetje dhe Kërkesa:

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +383 (0) 38 500 400 lok. 1090, 2059
e-mail: marketing@pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO